



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 652/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lart Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkritazi me ankesën e kandidatës për anëtarë të Kuvendit Komunal në Shtime, Kumrije Biba nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Shtime paraqitur kundër vendimit për shpalljen e rezultateve përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 08.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e parashtruar nga Kumrije Biba, kandidate për anëtar të Kuvendit Komunal Shtime, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me shenjë ZL.Anr.652/2017 të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit për shpalljen e rezultateve përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 08.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 09.11.2017, nga Kumrije Biba, kandidate për anëtar të Kuvendit Komunal të Shtimes, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Shtime, me të cilën pretendon se ka mospërputhje të rezultateve në mes FPR-së dhe rezultateve përfundimtare të KQZ-së. Parashtruesja e ankesës pretendon se dallimi në mes FPR-së dhe rezultateve përfundimtare të shpallura nga KQZ-ja është 4 pa i llogaritur votat me kusht dhe ato të diasporës me të cilën nga kjo mospërputhje e rezultateve është dëmtuar me humbjen e vendit në asamble.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë së ankesave dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore të ankueses gjeti se ankuesja me asnjë provë bindëse nuk ka dëshmuar dhe nuk ka specifikuar asnjë vendvotim me të cilën pretendon se janë shkaktuar parregullsi. Prandaj Paneli ankesën e ankueses e konsideron si

të përgjithësuar dhe të pa argumentuara me fakte dhe si të tilla jo bindëse pasi që nuk i plotësojnë kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në ankesë, konstaton se ankesa në fjalë është e pabazuar dhe e pa argumentuar dhe si të tillë ankesën e ankueses e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.652/2017 më datën 10.11.2017.



Kryesuesja e Panelit

Gjltene Sylejmani

Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*